




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



**RREGULLORE Nr. BA 2018/01
E PUNËS SË BORDIT PËR ANKESA**

Bordi për Ankesa;

Në mbështetje të nenit 42, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, miraton këtë:

RREGULLORE Nr. BA 2018/01 E PUNËS SË BORDIT PËR ANKESA

Neni 1 Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohen rregullat për trajtimin e rasteve lidhur me ankesat, procedurat dhe vendimmarrjen e Bordit për Ankesa.

Neni 2 Fushëveprimi

Kjo Rregullore zbatohet për Bordin për Ankesa si dhe palët pjesëmarrëse në procedurë.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin si në vijim:

1.1 Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) - organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale;

1.2 Bordi për Ankesa (BA) - organ i pavarur kompetent për shqyrtimin e ankesave të palëve ndaj vendimeve të KPM-së;

1.3 Zyra Ekzekutive (ZE) - është sekretariat i KPM-së për zbatimin e të gjitha detyrave të përcaktuara nga Bordi për Ankesa brenda kompetencave ligjore në pajtim me Ligjin e KPM-së;

1.4 Palët në procedurë pranë Bordit për Ankesa- Parashtruesi i ankesës dhe Komisioni i Pavarur i Mediave.

2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin e njëjtë si në Ligjin Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave si dhe aktet tjera që e rregullojnë këtë fushë.

Neni 4

Paraqitja e ankesës

1. Ankesa i parashtrohet Bordit për Ankesa brenda afatit prej 30 ditësh nga pranimi i Vendimit të KPM-së, përmes Zyrës Ekzekutive të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcjellet me dokumentet ose dëshmitë që mund të kërkohen nga Bordi për Ankesa në pajtim me këtë rregullore.
2. Ankesa duhet të përmbajë emrin dhe adresën e ankuesit, si dhe numrin dhe datën e vendimit të atakuar të KPM-së. Ankesa e paraqitur në njërën nga gjuhët zyrtare duhet të nënshkruhet nga Parashtruesi i ankesës.
3. Në ankesë mund të paraqitet ndonjë fakt ose argument, i cili nuk është shqyrtuar nga Komisioni gjatë marrjes së vendimit.
4. Nëse në Vendimin e KPM-së përfshihen dy apo më shumë palë me interes të njëjtë zbatohet neni 130 i Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
5. Vendirni i KPM-së atakohet për shkak të:
 - 5.1 vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike;
 - 5.2 aplikimit të gabuar të ligjit material;
 - 5.3 shkeljes së rregullave procedurale;
 - 5.4 sanksionit apo kushtit të vendosur.
6. Bordi për Ankesa do ta merr parasysh vetëm ankesën e bazuar në informacione ligjërisht relevante, apo të bazuar në mundësinë se ekziston gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.
7. Kur paraqitet ankesa kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Mediave, Bordi i Ankesave duhet të njoftohet nga shërbimi profesional administrativ i Zyrës Ekzekutive brenda tri (3) ditësh dhe të dërgohet ankesa me të gjitha shkresat e lëndës.
8. Kryetari i Bordit për Ankesa në bashkëpunim me Zyrën Ekzekutive therret takimet e Bordit për Ankesa.
9. Bordi për Ankesa gjatë shqyrtimit të ankesës, në rast se e konsideron të nevojshme, mund të ftojë palët në seancë të shqyrtimit, të cilët njoftohen tri (3) ditë para mbajtjes së seancës.
10. Palët e interesuara mund të kërkojnë nga Bordi për Ankesa leje për prezantim në seancë.

Neni 5

Provat dhe shkresat

1. Barra e paraqitjes së provave mbi të cilat mbështetet ankesa bie mbi parashtresin e ankesës.
2. Zyra Ekzekutive e KPM-së do t'i ofrojë parashtresit të ankesës qasje, në bazë të kërkesës, në të gjitha dokumentet në dosjen e rastit të KPM-së bazuar në Ligjin për Qasjen në Dokumentet Zyrtare.
3. Me kërkesën e parashtresit, Bordi për Ankesa mund të pranojë dokumente me shkrim nga palët e treta të cilat kanë interes në proces. Në raste të veçanta, Bordi për Ankesa mund të ftojë palën e tretë që të paraqitet para Bordit për Ankesa.

Neni 6

Delegimi i detyrave tek Zyra Ekzekutive

Bordi për Ankesa mund t'ia delegojë funksionet e tij Zyrës Ekzekutive të KPM-së në lidhje me pranueshmërinë e ankesave dhe materialit dëshmues si dhe njoftimin e palëve nën mbikëqyrjen e tij.

Neni 7

Seancat dhe gjuhët

1. Seancat para Bordit për Ankesa do të jenë të hapura përjashtimisht rasteve kur vendos Bordi për Ankesa.
2. Seancat shqyrtuese do të mbahen në gjuhët zyrtare me përkthim simultant apo të vazhdueshëm, sipas nevojës.
3. Nga seanca shqyrtuese mbahet procesverbal i cili pas përfundimit të saj nënshkruhet nga të pranishmit.

Neni 8

Përfaqësimi i Palëve

Palët në procedurë pranë Bordit për Ankesa mund të përfaqësohen nga personat e autorizuar.

Neni 9

Rrjedha e seancës

1. Kryetari i Bordit për Ankesa do të caktojë rrjedhën e seancës.
2. Kryetari e hap seancën dhe njofton të pranishmit me çështjen dhe pretendimet ankimore.

3. Cilido anëtar i Bordit për Ankesa mund të parashtrojë pyetje apo të kërkojë komente nga palët në procedurë lidhur me çfarëdo çështjeje ligjore ose faktike që ka të bëjë me procesin.
4. Bordi për Ankesa mund të kërkojë prova shtesë lidhur me çfarëdo çështjeje, që parashtrohet nga cilado palë gjatë procesit.
5. Bordi për Ankesa, sipas vendimit të vet apo sipas kërkesës së palëve në procedurë, mund të shtyj seancën për aq kohë sa konsiderohet e nevojshme.
6. Bordi për Ankesa merr vendime të nevojshme për të udhëhequr procesin në mënyrë të rregullt dhe në kohë.

Neni 10

Vendimmarrja e Bordit për Ankesa

1. Vendimet e Bordit për Ankesa merren me shumicë votash në seancën e këshillimit dhe votimit të cilën e drejton Kryetari, pasi të jetë plotësuar kushti i kuorumit, për secilin rast të veçantë.
2. Bordi për Ankesa me vendimin e tij mund të mbështesë, të ndryshojë ose të shfuqizojë çdo vendim të KPM-së, duke vepruar sipas ankesës për vendimet përkatëse.
3. Vendimi i Bordit për Ankesa do të jetë me shkrim dhe duhet të jetë i arsyetuar.
4. Këshillimi dhe votimi mbahen në seancë të mbyllur.
5. Në sallën ku Bordi për Ankesa mban këshillimin dhe votimin, të pranishëm mund të jenë vetëm anëtarët dhe procesmbajtësi.
6. Kryetari kujdeset për shqyrtimin e tërësishëm të të gjitha çështjeve nga çdo këndvështrim.
7. Procesverbali i këshillimit dhe votimit duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Bordit për Ankesa, si një dokument i brendshëm i Bordit për Ankesa. Anëtari që është kundër mund të shënojë votën e tij kundër. Vendimi i Bordit për Ankesa, me arsyetimin e plotë, duhet të lëshohet si një dokument tjetër i nënshkruar nga Kryetari i Bordit për Ankesa.
8. Arsyetimi i vendimit do të përmbajë konkluzionet e Bordit për Ankesa për faktet materiale, konkluzionet bazuar në ligjin në fuqi dhe vendimin e tij mbi aplikimin e ligjit në faktet e gjetura, duke pasur parasysh lirinë e gjyqimit.

Neni 11

Pavarësia dhe paanshmëria e anëtarëve të Bordit për Ankesa

1. Anëtarët e Bordit për Ankesa janë të pavarur në shqyrtimin e çdo çështjeje dhe marrjen e vendimeve nga kompetenca e vet ligjore.

2. Në çdo rrethanë e cila paraqet konflikt interesi sipas ligjit në fuqi, Bordi për Ankesa do ta refuzojë ankesën për shqyrtim.

Neni 12
Vendimi i Bordit për Ankesa

1. Vendimi do t'i dorëzohet palëve dhe do të publikohet në njërin nga gjuhët zyrtare në web-faqen e KPM-së.
2. Vendimet e Bordit për Ankesa janë përfundimtare dhe mund të atakohen në Gjykatën kompetente sipas Ligjit për Gjykatat.

Neni 13
Dispozita Përfundimtare

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja e Punës së Bordit për Ankesa BA 2017/01.

Neni 14
Hyrja në Fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Avdyl Hyseni

Kryetar i Bordit për Ankesa

05/04/2019